

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Fejzullah Rexhepi kryetar, Qerim Ademaj dhe Rrustem Thaqi anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F.B., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit XH.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.H., juriste e diplomuar, në çështjen për kompensim të dëmi, vlera e kontestit 34,500.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit dhe ankesën e të autorizuarës të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1195/12 të datës 08.10.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 14.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT si e themeltë ankesa e të autorizuarës të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1195/12, i datës 08.10.2014 dhe gjykohet si vijon: **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit F.B., nga Prishtina, **DETYROHET** e paditura t'i paguaj paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material: për dhimbje fizike, shumën prej 4,500.00€ (katërmijë e pesëqind euro), për frikën e pësuar, shumën prej 3,000.00€ (tremijë euro). **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e aprovuar, në emër të kompensimit të dëmit jo material: për dhimbje fizike shuma prej 1,000.00€ (njëmijë euro) dhe për frikën e pësuar, shuma prej 1,000.00€ (njëmijë euro), si dhe **NDRYSHOHET** pjesa që ka të bëjë me kamatën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ashtu që gjykon: **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në Prishtinë, që shumat e gjykuara, t'ia paguajë paditësit me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të shkallës së parë me datë 08.10.2014, e deri në pagesën definitive.

REFUZOHEN si të pa themelta ankesat e të autorizuarit të paditësit dhe e të autorizuarës të paditurës sa i përket vendosjes në pjesën tjetër të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1195/12, i datës 08.10.2014, dhe i njëjti **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1195/12 të datës 08.10.2014, në pikën një të dispozitivit të saj, ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit F.B. nga Prishtina, detyrohet e paditura Byrja Kosovare e Sigurimit (BKS), në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'ia paguajë shumat si vijon: për dhimbje fizike, shumën prej 5,500.00€, për frikën e pësuar, shumën prej 4,000.00€, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 6,000.00€, për shëmtim trupor, shumën prej 3,000.00€, ashtu që shuma e tërësishme e arrin vlerën prej 18,500.00€, me kamatë vonese 3.5%, nga data e marrjes së aktgjykimit 08.10.2014, e deri në përmbushjen definitive, bashkë me shpenzimet e procedurës në shumën prej 663€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pikën dy, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumat e aprovuara, dhe atë: për dhimbje fizike, shumën prej 2,500.00€, për frikën e pësuar, shumën prej 1,500.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 9,000.00€, dhe shëmtim trupor, shumën prej 2,000.00€, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e autorizuara e të paditurës, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë këtë ankesë të bazuar, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1195/12 të datës 08.10.2014, ta prishë dhe lëndën ta kthej në rivendosje, konform dispozitave ligjore të nenit 195.1, pika c), të LPK-së.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë edhe i autorizuari i paditësit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoi duke e aprovuar kërkesëpadinë- konkretisht precizimin e kërkesëpadiës, sa i përket kompensimit për të gjitha format e dëmit, apo ta vërtetoi aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

-Ankesa e të autorizuarës të paditurës është pjesërisht e themeltë

-Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi më datë 15.05.2012, ndaj të paditurës me kërkesë për kompensim dëmi, me vlerë kontesti prej 890.00€. Me datë 27.11.2013 e paditura ka paraqitur përgjigje në padi duke kontestuar në tërësi kërkesën dhe lartësinë e padisë së paditësit. Me datë 25.07.2014, paditësi ka bërë precizimin e padisë, duke pas parasysh mendimin e dhënë nga ekspertiza mjekësore me datë 20.06.2014, të dhënë nga Dr. S.D.- ortoped-traumatolog dhe Dr. N.M.- psikiatër.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore, administroi dhe vlerësoi si prova, raportin e aksidentit me numër 12-AR-420 të datës 15.04.2012, aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë, me numër P.nr.2527/2012 të datës 26.11.2012, raportin nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë, me numër 10703, të datës 18.04.2012, fletë lëshimin me numër të historisë 587 dhe raportet e tjera mjekësore që gjenden në shkresa të lëndës, si dhe mendimin e ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë të datës 20.06.2014, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar padinë e paditësit, në pajtim me nenin 4.1 pika a) dhe 4.6 të Rregullit 3, për ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë (që ka hy në fuqi me 1 tetor 2008), nenin 154, 178 al.1, 200 al.1, dhe nenin 277 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mori në pajtim me nenin 449 dhe 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjyimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore të palëve dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara sipas ankesës, si dhe nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e të paditurës si në ankesë se aktgjykimi i atakuar është nxjerrë në shkelje të dispozitave thelbësore dhe se në aktgjykimin e atakuar nuk janë dhënë arsye për mënyrën e vendosjes, nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara, pasi dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është i qartë dhe janë dhënë arsye për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv.

Gjykata e Apelit lidhur me aktgjykimin e atakuar sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, vlerëson se gjykata e shkallës së parë rregullisht dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike sa i përket pjesës së ndryshuar dhe vërtetuar sipas këtij aktgjykimi, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike.

Mirëpo për kundër vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, përkitazi me aspektet e dëmit jo material dhe vlerësimin të

lartësisë së aprovuar, duke aprovuar shumat tepër të larta, sa i përket shumës për dhimbje fizike, shumën prej 5,500.00€ dhe për frikën e pësuar, shumën prej 4,000.00€, të cilat nuk janë në përputhje me qëllimin e kompensimit të dëmit, të cilat kjo Gjykatë edhe i ka ndryshuar, duke i gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket shumave tjera të gjykuara si në aktgjykimin e atakuar i ka vërtetuar si të drejta dhe reale.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes vlerëson se paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 154, 178 dhe 200 të LMD-së, si dhe nenit 323 të LPK-së, ku vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është bërë duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, vuajtjet e pësuar për shkak të ndodhjes së aksidentit, moshën e paditësit (21.07.1983), në kohën kur ka ndodhur aksidenti, ku shumat e gjykuara në emër të shpërblimit të dëmit jo-material, paraqitet si shpërblim i drejtë dhe se shumat e aprovuara paraqesin një formë të satisfacionit të paditësit i cili me këto mjete mund të plotësojë nevojat dhe të mirat materiale të tij, që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike, raportin e aksidentit me numër 12-AR-420 të datës 15.04.2012, aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, me numër P.nr.2527/2012 të datës 26.11.2012, raportin nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë, me numër 10703, të datës 18.04.2012, fletë lëshimin me numër të historisë 587, si dhe vërtetimin e provave të tjera dhe gjendjen faktike në tërësi, në bazë të cilave ka vërtetuar se në bazë të aksidentit i cili ka ndodhur me datë 15.04.2012, në Verënik-Hajvali, ku ngasësi i motoçikletës, duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes, ka ndërmarr veprim- kthim gjysmë rrethor, dhe e humb kontrollin mbi motoçikletën duke u rrokullisur në rrugë në anën e djathtë, i cili nuk ka poseduar patentë shofer dhe motoçikleta e tij ishte e pa regjistruar, që nga data 15.09.2009, me ç' rast paditësi pëson lëndime të rënda trupore, ku edhe është dërguar në QKUK për trajtim mjekësor, andaj nga kjo rrjedhë edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në këtë aksident. Përgjegjësinë për kompensimin e dëmit nuk e ka kontestuar as vet e paditura, e cila sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë është pajtuar përmes të autorizuarës së saj gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, por vetëm është kontestuar lartësia e kërkesëpadisë, ku edhe i kishte ofruar palës paditëse pajtim gjyqësor, duke i ofruar kompensimin prej 6,000.00€. Andaj pretendimet si në ankesë se aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye nëse ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, janë të pa bazuara, pasi faktet jo kontestuese gjatë shqyrtimit nuk është e nevojshme të arsyetohen në aktgjykim.

Gjykata e Apelit me rastin e ndryshimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka vendosur në bazë të nenit 178 të LMD-së, ku e parasheh se në rast të aksidentit të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë, ndërsa baza për kompensimin e dëmit e paditësit në raport me të paditurën ekziston edhe në bazë të

nenit 200 të LMD-së, ndërsa lartësinë e dëmit material dhe jo material e përcakton gjykata sipas vlerësimit të vet të lirë e në bazë të nenit 323 të LPK-së.

Gjykata e Apelit konsideron se lartësia e kompensimit të dëmit të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në emër të dëmit jo material, sa i përket shumës për dhimbje fizike dhe frikën e pësuar, kanë qenë të larta, andaj edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, duke gjykuar që paditësit të ia njoh kompensimin në emër të demit jo material, për dhimbje fizike, shumën prej 4,500.00€, dhe për frikën e pësuar, shumën prej 3,000.00€, ku të njëjtat i ka refuzuar përtej kësaj shume të aprovuar, duke i gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi edhe në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor Dr. S.D. ortoped- traumatolog dhe N.M.- eksperte e psikiatrisë, ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, kanë konstatuar se paditësi në aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat janë karakterizuar me thyerje multifragmentare e hapur e pjesës distale të parakrahut të anës së djathtë të shkallës së I- (parë), thyerje të kockës skafoide të dorës së djathtë dhe artrozë e shkallës së rëndë dhe shtangim i nyjës së dorës së djathtë, duke bërë specifikimin në mënyrë të veçantë edhe për dhimbjet e pësuar, frikën e përjetuar, kohëzgjatjen e saj, shëmtimi trupor i paraqitur dhe i shprehur tek paditësi, aktiviteti jetësor i zvogëluar i shprehur në përqindje prej 20%, se ka pasur nevojë për përkujdesje të personit tjetër për 28 ditë, ushqim të përforcuar për 21 ditë, ka marr për bazë të gjithë parametrat, nuk ka pasur ndonjë vërejtje e cila vërejtje do të vinte në dyshim validitetin e saj, të cilës gjykata me të drejtë ia falë besimin e plotë dhe vendosi konform saj, pasi nga mendimi i ekspertëve mjekësor u vërtetua se lëndimet e pësuar janë të natyrës së rëndë trupore dhe si pasojë e në përputhje me natyrën e lëndimeve, ku shuma e gjykuar në emër të kompensimit të dëmit jo material, është në përpjesëtim dhe në harmoni me natyrën lëndimeve të marra, i cili me këto mjete mund të plotësojë nevojat dhe të mirat materiale të tij, që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit.

Gjykata e Apelit me rastin e ndryshimit të aktgjykimin të atakuar, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e aprovuar, në emër të kompensimit të dëmit jo material: për dhimbje fizike shumën prej 1,000.00€ dhe për frikën e pësuar, shumën prej 1,000.00€, pasi ka vlerësuar se shumat e refuzuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë vlerësuar si tepër të larta dhe që tejkalojnë qëllimin e kompensimit të dëmit, andaj të njëjtat i ndryshoi dhe i gjykoi si në dispozitiv, si shuma reale dhe konform praktikës gjyqësore.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar aktgjykimin e atakuar edhe në pjesën refuzuese, mirëpo gjeti se pretendimet në ankesë të palës paditëse, në këtë pjesë, janë të pa bazuara, andaj vendosi që pjesën me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, ta vërtetoi, pasi Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar të drejtën materiale, duke i gjykuar shumat sikurse në dispozitiv të saj, dhe se të njëjtat shuma nuk janë të ulta dhe jo në pajtim me praktikën gjyqësore, ku pala paditëse ka kërkuar shumë më të lartë për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, ndërsa Gjykata në shkallë të parë, për zvogëlimin e aktivitetit të

përgjithshëm jetësor, ka aprovuar shumën prej 6,000.00€, si shumë reale dhe e pranueshme në raport me lëndimet që ka pësuar paditësi, ku të njëjtat vlerësime i pranoi edhe kjo Gjykatë, me përjashtim të kompensimit të dëmit, sa i përket shumës për dhimbje fizike dhe frikën e pësuar, që i ka konsideruar si tepër të larta, duke i ndryshuar dhe duke i refuzuar përtej shumës së aprovuar, sikurse në dispozitiv të lartcekur.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar sa i përket gjykimit për kamatë, ashtu si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, aktgjykimi i atakuar është ndryshuar ashtu që duhet të jetë: për shumat e gjykuara për dëmin jo material, si në dispozitiv të aktgjyimit të vërtetuar, me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një viti pa destinim të caktuar, prej momentit të nxjerrjes së aktgjyimit të shkallës së parë, datë 08.10.2014, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e vërtetuar edhe pjesën për shpenzimet e procedurës, me të cilën e paditura është obliguar që t'ia kompensoj paditësit në shumë prej 663€, ku i ka specifikuar në mënyrë të veçantë sikurse në arsyetim të saj, ku është vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në pajtim me nenin 449 dhe 452 par.1 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), dhe e) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4760/2014, më datë 14.11.2018

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Fejzullah Rexhepi